



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 27, datë 17.09.2025

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZOTIT ASIM VOKSHI NË VENDIN VAKANT, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPLLUR NGA GJYKATA E LARTË MË DATË 11.12.2024

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Fuat Vjerdha	Anëtar
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Irma Balli	Anëtare
Etien Kapo	Anëtar
Nafije Hasko	Anëtar

Asistuar nga sekretare Katerina Bilo me praninë e Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mungesë të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në mbledhjen e datës 17.09.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Asim Vokshi

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 11.12.2024.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Enkela Vlora, veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit për këtë kandidat, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (në vijim referuar edhe si KED) me vendimin nr. 14, datë 17.06.2025 ka vendosur *“Lejimin e kandidimit të kandidatit Asim Vokshi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024”*, vakancë e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas deklaramentit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

1.1 Pas vendimmarrjes nr. 14, datë 17.06.2025 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konstatohet se Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ka përcjell pranë Këshillit, shkresën me informacion me përmbajtje të klasifikuar “sekret” në lidhje me kandidatin (*gjatë muajt qershor dhe gusht 2025*). Me qëllim verifikimit të informacioneve të mësipërme, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kreu veprimtarinë hetimore administrative të nevojshme për rastin konkret, si verifikime në rrugë shkresore pranë AKSIK-së, ILDKPKI-së si dhe bankave të ndryshme të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe takime të drejtëpërdrejta të anëtarëve të caktuar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese. Përgjatë hetimit administrativ, Këshilli ka mbajtur mbledhje me dyer të mbyllura, të cilat janë dokumentuar me procesverbalet përkatëse të datave 11.09.2025 dhe 16.09.2025. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbështetje të nenit 14/1 të Vendimit nr. 5/2019 të KED, në datë 16.09.2025 referuar dokumentacionit të paraqitur ka konkluduar *se nuk ndodhemi përpara kushteve të rishikimit të Vendimit nr. 14, datë 17.06.2025 të KED*.

1.2 Vendimmarrjen e mësipërme, Këshilli e ka bazuar në rezultatet e përfituara nga verifikimet përkatëse, po ashtu edhe në aksesin e kufizuar që AKSIK dhe institucionet ligjzbatuese i kanë ofruar në lidhje me verifikimin e një pjese të informacionit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se ushtrimi i funksionit të tij verifikues kërkon jo vetëm administrimin formal të informacionit, por një akses real dhe të mjaftueshëm në materialet e përcjella nga organet kompetente. Ky standard është i domosdoshëm për të krijuar bindjen e brendshme mbi besueshmërinë dhe bazueshmërinë e të dhënave, veçanërisht në rastet që lidhen me sigurinë kombëtare. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (*shih çështjet Lupşa k. Rumanisë, C.G. dhe të tjerë k. Bullgarisë, Regner k. Republikës Çeke*), si dhe me praktikën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*Hanem Mohamed & Abdelaziz Ibrahim kundër Ministrisë së Brendshme, vendimi nr. 00-2021-142*), është ritheksuar se barrën e provës dhe detyrimin për të ofruar informacion të plotë e mban organi publik që administron të dhënat e klasifikuara. Ky organ duhet të sigurojë që materiali i përcjellë të jetë i mjaftueshëm, i arsyetuar dhe i kontrollueshëm, në mënyrë që organi vendimmarrës të ketë mundësinë të formojë një bindje të bazuar.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtarja e Këshillit, znj. Enkela Vlora, në cilësinë e relatores të vendit vakant të cituar më lart, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore të relatores dhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga secili kandidat, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve, me vendimin e datës 09.09.2025 ka vendosur

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

4. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati Asim Vokshi në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit, relatore e vendit vakant në të cilën kandidati ka paraqitur kandidaturën e tij, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e vlerësimit të këtij kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i cili i është njoftuar kandidatis.

5. Kryetari i Këshillit ka thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 16.09.2025, ora 13:00, për zhvillimin e intervistës dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj me kandidatët e lejuar. Kandidati Asim Vokshi përzgjodhi të intervistohet në gjuhë të huaj (anglisht), për pasojë me vendimin nr. 26, datë 11.09.2025 të KED, u vendos marrja e ekspertit të gjuhës së huaj. Në datë 12.09.2025, kandidati u njoftua për vendimin për caktimin e datës së intervistës dhe testimin të gjuhës së huaj si dhe caktimin e ekspertës. Kandidati mori dijeni, duke deklaruar se nuk ka shkaqe papajtueshmërie me ekspertin.

6. Intervista mbi motivimin e kandidimit me kandidatin Asim Vokshi u zhvillua në mbledhjen e Këshillit të datës 16.09.2025.

II. Parimet dhe burimet ligjore që udhëheqin vlerësimin

7. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) vepron mbi bazën e Kushtetutës dhe Ligjit nr. 115/2016, duke zbatuar rregullat procedurale të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 (procedura e verifikimit) dhe metodologjinë e Vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 (kriteret/peshët e pikëzimit). Këto akte garantojnë kompetencën e organit, rregullshmërinë formale dhe mjetet e transparencës për një vendimmarrje të arsyetuar, të verifikueshme dhe të drejtë. Parimet mbizotëruese: *(i) ligjshmëria, (ii) barazia dhe mosdiskriminimi, (iii) paanësia dhe shmangia e konfliktit të interesit, (iv) e drejta e dëgjimit dhe transparenca, (v) proporcionaliteti dhe arsyetimi, (vi) parashikueshmëria dhe konsistenca në zbatimin e kriterëve.*

8. *Rregullshmëria procedurale (shorti, njoftimet, verifikimi, votimi)* Procesi i vlerësimit nisi me caktimin me short të relatorit dhe përcaktimin e këshilltarëve ligjorë; vijoi me njoftimet ndaj institucioneve dhe kandidatëve, administrimin e materialeve, verifikimet sipas Vendimit nr. 4 (përfshirë kontrollet e integritetit, pasurisë dhe papajtueshmërisë) dhe me mbledhjen ku bëhet diskutimi i raporteve dhe votimi i hapur. Publikimi i rezultatit dhe përgatitja e “raportit të arsyetuar” siguron transparencën e aktit përfundimtar.

8.1 Respektimi i këtyre hapave është kusht i domosdoshëm për ligjshmërinë e pikëzimit: dështimi në cilindo hap do të çenonte aktin. Në rastin konkret, dokumentet e administruara dhe tabelat përfundimtare pasqyrojnë ecuri të përputhur me skemën ligjore.

9. *Metodologjia: kriteret dhe “mesatarja kolegjiale”.* Metodologjia e KED strukturohet në tri blloqe: (1) Meritat Profesionale (deri 60 pikë), (2) Meritat Morale (deri 30 pikë), (3) Meritat Organizative/Drejtues-Menaxheriale (deri 10 pikë). Brenda secilit bllok, nën-kriteret dhe indikatorët janë të paracaktuar (p.sh., vjetërsi/arsim/“pesë dokumente”/gjuhë për bllokun profesional; integritet/reputacion për bllokun moral; platforma/vizioni për bllokun organizativ).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

10. Çdo anëtar i KED vlerëson individualisht; rezultati përfundimtar është mesatarja e pikëve të 9 anëtarëve (“mesatarja kolegjiale”). Kjo teknikë zvogëlon ndikimin e çdo skaji individual (shumë i lartë ose shumë i ulët) dhe e bën totalin produkt të një vlerësimi kolegjial, jo të një individi. Për rrjedhojë, edhe kur anëtarët ndryshojnë në nuanca, ligjshmëria e vendimit ruhet nëse kriteret zbatohen njësoj dhe arsyetimi është i pranishëm.

11. *Testet e ligjshmërisë së vlerësimit (kontrolli i brendshëm i KED).* Për të qenë i qëndrueshëm juridikisht, pikëzimi kalon disa “teste” të brendshme kontrolli:

- Testi i kompetencës dhe formës: organi i duhur, akti në formën e ligjit dhe rregullit të brendshëm; procesverbalet dhe tabelat ekzistuese;

- Testi i procedurës: shorti, njoftimet, verifikimi, e drejta e dëgjimit, mbledhja, votimi i hapur, raportimi i arsyetuar.

- Testi i kriterit: zbatimi i njëjtë i metodologjisë (60/30/10) për të gjithë kandidatët, pa shmangie nga treguesit e paracaktuar.

- Testi i barazisë: trajtim i njëjtë i situatave të njëjta dhe arsyetim i diferencave kur ekzistojnë.

- Testi i proporcionalitetit: pikët në raport të drejtë me provat (as nën- e as mbi-vlerësim i pajustificuar).

- Testi i arsyetimit: lidhje e qartë “provë → nën-kriter → pikë → total”.

- Testi i transparencës: publikim i renditjes dhe tabelave, mundësia e verifikimit publik.

III. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

12. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidatit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati Asim Vokshi në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera të kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Asim Vokshi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;

b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuar, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;

c) në detajimin e mëtejshëm të kritereve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimin më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

13. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “Vjetërsia në profesion”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

14. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen e të gjithë përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Asim Vokshi, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

-Korrik 2021 – në vijim, Gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë.

-Nëntor 2016 - Korrik 2021, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

-Tetor 2005 - Nëntor 2016, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

15.1 Po ashtu, kandidati Asim Vokshi rezulton të ketë ushtruar edhe detyra të tjera gjatë karrierës së tij profesionale përveç atij të magjistratit (gjyqtar), si vijon:

-Nëntor 2022 - Qershor 2024, ekspert ndërkombëtar me eksperiencë (senior) fillimisht kontraktuar afatshkurtër dhe pastaj afatmesëm, pranë Projektit EUKOJUST i Bashkimit Evropian në Kosovë.

-Tetor 2020 - Tetor 2024, pedagog i jashtëm, pranë Shkollës së Magjistraturës.

-Tetor 2008 - Tetor 2024, ekspert në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës

-Shkurt 2017 - Mars 2017, ekspert i jashtëm në Komisionit të Ligjeve pranë Kuvendit të Shqipërisë.

-Tetor 2006 - Korrik 2015, pedagog i jashtëm, pranë Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës.

-Korrik 2003 - shtator 2003, jurist Projekti Avokati i Qytetit pranë Bashkisë Tiranë.

-Nëntor 2002-qershor 2003, asistent ligjor pranë Tirana Legal Aid Society (TLAS-CAFOD).

16. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se në rastet e veprimtarisë gjyqësore kandidati Asim Vokshi ka ushtruar veprimtari profesionale në fushat e përcaktuara sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, si dhe në mbështetje të shkresës nr. 1102/1 prot., datë 28.02.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se vjetërsia e kandidatit Asim Vokshi në ushtrimin e funksionit të magjistratit (gjyqtar) është 19 vite, 4 muaj, 21 ditë, ndërsa vjetërsia e përgjithshme duke përfshirë edhe periudhat e punësimit përpara emërimit gjyqtar (sipas deklarimeve në jetëshkrimin e kandidatit, pa përfshirë angazhimin e tij pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Fakultetit të Drejtësisë) është 20 vite, 2 muaj, 21 ditë.

17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale të sipërcituara, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Asim Vokshi me **18 Pikë**.

Historiku Arsimor

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

18. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

19. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Asim Vokshi ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës gjatë viteve 1999-2003, me notë mesatare 9.69, e njëjtë me vetëdeklarimin e bërë nga kandidati Asim Vokshi në jetëshkrimin e tij.

Po ashtu, kandidati ka përfunduar studimet Master në të Drejtë Civile, pranë Universitetit të Tiranës, gjatë viteve 2006-2008, me notë mesatare 10.

21. Për sa më lart, nisur nga përlllogaritja e kryer nga Këshilli sipas të cilës nota mesatare e arritur nga kandidati Asim Vokshi gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës është 9.69, për kriterin e vlerësimit “*historiku arsimor*”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin me **18 Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

22. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

23. Referuar kriterëve ligjorë të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.

24. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

25. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton se kandidati Asim Vokshi ka tituj akademik/profesional dhe grada shkencore, në rend kronologjik si vijon:

-Ka përfunduar studimet universitare dhe është diplomuar për periudhën 1999 - 2003 si “Jurist”, në Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, me notë mesatare 9.69.

- Në jetëshkrimin e kandidatit dhe sipas akteve bashkëlidhur dosjes së kandidimit evidentohet se kandidati ka fituar titullin profesional Magjistrat/Gjyqtar, me diplomën e lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës me nr. 89/A, në periudhën tetor 2003-qershor 2006.

- Gjatë periudhës 2006-2008 ka përfunduar studimet Master Shkencat Civile, në të Drejtë Civile, Universiteti i Tiranës, nota mesatare 10.

-Në jetëshkrimin e kandidatit dhe sipas akteve bashkëlidhur dosjes së kandidimit evidentohet se në periudhën gusht 2012 deri në maj 2013, kandidati ka përfunduar studimet pasuniversitare LLM në të drejtën e Krahësuar me Përqëndrim në të Drejtë Biznesi, Shkolla e Drejtësisë së Universitetit të San Diegos.

- Në jetëshkrimin e kandidatit dhe sipas akteve bashkëlidhur dosjes së kandidimit, evidentohet se kandidati ka fituar gradën shkencore “Doktor” me diplomë doktrate nr. 1278, datë 04.03.2016, në të Drejtë Civile/Procedurë Civile, pranë Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës;

26. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Caktimin e Pikëve për kandidatin do të mbahet në vëmendje se ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës duke fituar titullin profesional “Gjyqtar”, ka përfunduar studime pasuniversitare në nivelin Master Shkencat Civile, në të Drejtë Civile, Universiteti i Tiranës/master ekzekutiv;kandidati mban titullin akademik “Doktor” si dhe që ka një LLM të përfunduar në SHBA. Për këto arsye, për këtë kriter vlerësimi, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Asim Vokshi me **53 Pikë**.

27. Për treguesin e vlerësimit “*Trajnimit e tjera*”, vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, duke mbajtur parasysht edhe numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi. Lidhur me këtë kriter vlerësimi, Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.

28. Nga akti dokument i jetëshkrimit të kandidatit që ndodhet në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Asim Vokshi, deklaroi se ka kryer këto trajnime:

Akte dorëzuar fizikisht pranë KED:

Periudha: 22 Qershor 2012

- Tematika: “Zgjidhja e Konfliktëve që burojnë nga kontratat administrative dhe civile përmes shqyrtimit të tyre në arbitrazhin ndërkombëtar dhe vendas. Rastet kur vendimet e arbitrazhit janë ankimuar në gjykatat e apelit brenda vendit dhe rastet e arbitrazhit ndërkombëtar të Londrës dhe Parisit në rastet kur subjektet shqiptare kanë qenë palë në procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar”, Tiranë, nga Shkolla e magjistraturës.

-Periudha: 13-14 Dhjetor 2010

Tematika: “Alternativat e dënimit pas reformës së sistemit të dënimeve dhe ekzekutimi i tyre, problem të praktikës gjyqësore dhe përfaqësja me përvojën Evropiane”, nga Shkolla e magjistraturës.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

-Periudha: 20-21 Dhjetor 2010

Tematika: Certifikatë për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Koncepti Juridik i pasurive të paluajtshme. Sendet e paluajtshme, pjesët përbërëse dhe aksesoret e tyre. Çështjet që lidhen me ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe konfliktet gjyqësore”, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 28 Maj 2012

Tematika: “Kontratat e reja, Ligji i Koncesionit, Kontratat administrative”, Tiranë, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 30-31 Maj 2012

Tematika: “Zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale”, Razëm, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 13 Prill 2012

Tematika: “Tituj ekzekutivë në procedurën civile dhe titujt ekzekutivë në kuptimin e ligjit të posaçëm. Praktikë lidhur me moskëqetimin e detyrimeve të shtetit ndaj individëve. Detyrimet që burojnë prej vendimeve gjyqësore. Aktet e dhënies së kredisë bankare si titull ekzekutiv dhe nocioni i urdhërit të ekzekutimit i lidhur me të” Tiranë 12-nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 14 Dhjetor 2011

Tematika: “Përforcimi i njohurive për dënimet alternative dhe ekzekutimin e tyre” Tiranë me nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 21-22 Prill 2011

Tematika: “ Kontrata e sipërmarrjes në fushën e ndërtimeve. Dallimi i saj nga kontrata e porosisë. Risku i sipërmarrjes dhe format e tij. Kalimi i pronësisë për sipërmarrjet në ndërtimin e sendeve të paluajtshme. Praktika gjyqësore lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga kontrata e sipërmarrjes” Tiranë, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 14 Dhjetor 2011

Tematika: “Përforcimi i njohurive për dënimet alternative dhe ekzekutimin e tyre”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 25-26 Tetor 2011

Tematika: “E drejta Europiane e konkurrencës në praktikën shqiptare”, Tiranë, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 8-9 Nëntor 2010

Tematika: “Pronësia industriale”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 22-23 Prill 2010

Tematika: “Ndryshimet e reja në kodin e Procedurës Civile. Disa nga problematikat me karakter teorik dhe praktik që kanë lindur ose mund të lindin në praktikën gjyqësore duke u fokusuar tek ekzekutimi i vendimeve gjyqësore”, Tiranë, nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 18-19 Mars 2010

Tematika: “Probleme të gjykimit në mungesë në procesin penal. Aspekte të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, në përjasje me vendimet e GJEDNJ”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 18-19 Shkurt 2010

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Tematika: “Probleme të pavlefshmërisë së akteve procedural penale. Praktika gjyqësore dhe praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë. Pavlefshmëria e njoftimeve” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 11-12 Janar 2010

Tematika: “Paditë për mbrojtjen e së drejtës së trashëgimisë. Padia për kërkimin e trashëgimit, kthimin e pasurisë trashëgimore, njohjen e trashëgimit, rastet dhe kushtet e ngritjes së tyre” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 5-6 June 2025

Tematika: “EU Competition Law Enforcement in Action. Highlights from National Courts” Florence.

-Periudha: 13-14 Maj 2008

Tematika: “Mosmarrëveshjet lidhur me tatim taksat, vlerësimet tatimore dhe kundërshtimet e tyre” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 28-29 Qershor 2007

Tematika: “Pavlefshmëria e akteve të shoqërive dhe akteve të themelimit të tyre” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 21-22 Qershor 2007

Tematika: “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 2,3,5,6” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 5-6 Prill 2007

Tematika: “Kontratat e sipërmarrjes, kushtet, forma dhe detyrimet e palëve” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: Tetor 2000

Tematika: “E Drejta Penale Ndërkombëtare dhe Krimi i Organizuar”, Fakultetit i Drejtësisë, Tiranë.

-Periudha: 20 Tetor 2003

Tematika: “E drejta Materiale Europiane, Aspekte Ligjore të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimi dhe Përafrimi i Legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së” nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 4-5 Prill 2006

Tematika: “Ekzekutimi i detyrueshëm. Mjetet e Mbrojtjes ndaj ekzekutimit të vendimeve” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 1-2 Mars 2006

-Tematika: “Veprimet Juridike. Pavlefshmëria e veprimeve juridike”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 24-25 Janar 2006

Tematika: “Gjykimet e Posaçme” nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 10 Shkurt 2006

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Tematika: “Kuptimi dhe Interpretimi Drejtë i Regjimeve Pasurore Martesore nga Gjyqtarët” nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 30 Pril 2008

Tematika: Completed trained course to become a national trainer on the European Convention on Human Rights.

-Periudha: 11-15 Nëntor 2002

Tematika: “Stop Korrupsionit !”. Certifikatë mbi kontributon e dhënë dhe dedikimin e treguar mbi sensibilizimin dhe njohjen e ligjit nga komuniteti mbi tematikën.

-Periudha: 21 Maj 2002

Tematika: “Ligjet në biznes” nga Fondacioni për Edukimin Ekonomik të Rinjve

-Periudha: 29 Prill 2005

-Tematika “Use of Labour International Standarts and the Labour Law in Albania” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: Shtator – Nëntor 2004

Tematika: “Demokracia dhe Pjesëmarrja” .

-Periudha: 25-26 Tetor 2005

Tematika: “Fair Trial” Tiranë.

-Certifikatë për ndihmesën e dhënë dhe përkushtimin e treguar në shërbim të ndërgjegjësimit dhe njohjes së ligjit nga komuniteti në aktivitetin Street Law në trajnimin me temë “10 Maji, Dita Kombëtare e Drejtësisë”.

-Periudha: 22-23 Nëntor 2005

Tematika: “Kodi i ri i Familjes” Tiranë 2005 nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 13-14 Maj 2019

Tematika: “Parashkrimi fitues përballë mënyrave të tjera origjinale të fitimit të pronësisë” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 24 Maj 2019

Tematika: “Njoftimet dhe pavlefshmëria e tyre” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 6-7 Shkurt 2019

Tematika: “Përqasja e Legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së në fushë e sigurimeve nga kompanitë e sigurimeve” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 30 Nëntor 2016

Tematika: “Procedurat e falimentit” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 27 Shtator 2023

Tematika: “Training of trainers on the methodology of Mock-Trial based training on trafficking in persons”, OCCE, Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 14-17 Shkurt 2017

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Tematika: “Training of Trainers” seminar i organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, JUFREX, Vlorë.

-Periudha: 11-12 Prill 2016

Tematika: “Ekzekutimi i detyrueshëm. Mjetet e Mbrojtjes” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 12-13 Dhjetor 2016

Tematika: “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Standarti I GJEDNJ për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Masat e sigurimit civil të padisë” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 8 Qershor 2015

Tematika: “Konventat e Hagës dhe zbatimi I tyre në legjislacionin shqiptar. Mbrojtja e të drejtave themelore dhe Konventa e Hagës” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 26-27 Mars 2014

Tematika: “E drejta e pronës. Legjislacioni Shqiptar dhe Jurisprudenca e GJEDNJ-së” Tiranë.

- Periudha: 10-11 Dhjetor 2013

Certifikatë për pjesëmarrjen në Judicial Opinion Eriting Program Tiranë.

-Periudha: 19-21 Dhjetor 2016

Tematika: “Metodologjia e HELP” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 30 Nëntor 2016

Tematika: “Procedurat e falimentit. Njohuri me standartet ndërkombëtare dhe legjislacionin e praktikën gjyqësore vendase në fushën e falimentimit. Roli I gjykatës së apelit” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 9-10 Nëntor

Tematika: “Raste praktike KEDNJ” Tiranë 2016 nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 21-22 Prill 2016

Tematika: “Barra e provës në çështjet e konkurrencës, procedurat përpara gjykatës”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Tematika: 27-28 Mars 2017

Tematika: “Gjykimet e posaçme dhe reforma e procesit penal. Gjykimi i shkurtuar. Gjykimi i drejtpërdrejtë. Gjykimi me marrëveshje. Gjykimi me urdhër penal” Tiranë, Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 13 Mars 2017

Tematika: “Shkrim arsyetim ligjor. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore, elementët e tij sipas dispozitave procedurale dhe material. Pasojat e mosarsyetimit të vendimit” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 20 Qershor 2017

Tematika: “Aftësitë e kontabilitetit për gjyqtarët dhe prokurorët në çështjet e falimentimit” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

-Periudha: 6-7 Dhjetor 2017

Tematika: “Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 4-5 Korrik 2018

Tematika: “Ndërhurja e juridiksionit administrative me atë civil në rastet e përmbushjes/mospërmbushjes së detyrimeve në një kontratë administrative”, Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 10-11 Maj 2018

Tematika: “Detyrimet që burojnë nga faza parakontraktore” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 5-6 Shkurt 2018

Tematika: “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 9-10 Qershor 2015

Tematika: “Problematika e çështjeve që kanë lidhje me legjislacionin për sigurimet shoqërore” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

-Periudha: 3 Mars 2015

Tematika: “Etika Profesionale” Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës.

19.1 Po ashtu nga jetëshkrimi i kandidatit rezulton të jenë deklaruar trajnime dhe stazhe profesionale tej atyre të sipërcituara, si vijon:

Periudha: 2-6 Tetor 2023

Stazh pranë Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë. Shkëmbim eksperience profesionale me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë, Itali.

Periudha: 22-24 Shkurt 2023

Tematika: “Zhvillimet e Fundit në zbatimin e nenit 102 të TFEU”, Pragë.

Periudha: 3-4 Qershor 2022

Tematika: “Etika Gjyqësore, Paragjykimet dhe Konflikti i Interesit”.

Periudha: 02-13 Shtator 2019

Tematika “Shkëmbim i Përvojës Profesionale”, Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të Landit Hamburg, Bruksel.

Periudha: 13-14 Maj 2019

Tematika: “Krimi Kibernetik”, Shkolla e Magjistraturës.

Periudha: 16.11.2018

Tematika: “Kufijtë e gjyqimit në Gjykatën e Lartë dhe roli i Gjykatës së Lartë në praktikën gjyqësore”.

Periudha: 12-13 Nëntor 2018

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Tematika: “Provat dhe përdorshmëria e provave të marra në kundërshtim me ligjin”.

Periudha: 28.06.2018

Tematika: Raporti i gjykatës me median, Shkolla e Magjistraturës.

Periudha: 18.01.2018

Tematika: Drejtësia administrative, Shkolla e Magjistraturës.

Periudha: 9-25 Nëntor 2005

Tematika: “Përditësimi me të drejtën civile për magjistratët shqiptarë”.

Periudha: 27 Korrik 2002

Tematika: “Zhvillimi i Liderëve të Komunitetit”, The Youth Organize Institute, Rumani.

Periudha: 27 Mars- 15 Maj 2002

Tematika: Metodat e kërkimit, Qendra për Kërkimet mbi Refugjatët dhe Migracionin.

Periudha: 29 Prill- 4 Maj 2002

Tematika: “Pronësinë, administratimin dhe të drejtat mbi tokën”, Fakulteti i Drejtësisë.

Periudha: 2001

Tematika: “Zhvillimet e reja në të drejtën evropiane”, Fakulteti i Drejtësisë.

Periudha: 2001

Tematika: ‘Të drejtën ndërkombëtare penale dhe krimin e organizuar’, Fakulteti i Drejtësisë.

29. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e jetëshkrimit të kandidatit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si dhe duke pasur parasysh se kandidati ka trajnime të përvitshme si gjyqtar, numrin, llojin, kohëzgjatjen, shtrirjen në kohë dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura prej tij, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **18 Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

30. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

31. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

32. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njeh në nivel shumë të mirë gjuhën angleze dhe italiane në nivel të mirë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Kandidati ka depozituar certifikatë e gjuhës angleze IELTS, datë 18.09.2014¹ me vlerësim në tërësi 7.5 dhe dëshmi nr. 4911, datë 08.04.2001 lëshura nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me vlerësim 71 pikë në gjuhën italiane.

33. Në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Caktimit të Pikëve lidhur me këtë kriter vlerësimi citohet ndër të tjera se, për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur Këshilli e vlerëson të nevojshme, do të caktojë ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es mund të vlerësohet deri në 3 Pikë. Gjithashtu, Këshilli mban parasysht edhe zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara për të cilat kandidati/ja nuk testohet gjatë intervistës, me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Në këtë rast, krahas vlerësimit konkret me pikë për gjuhën e huaj të zgjedhur prej tij/saj për pikëzim, kandidatit/es mund t'i shtohet 1 Pikë.

34. Kandidati Asim Vokshi u testua për nivelin e njohurive të gjuhës së huaj (*anglisht*) dhe sipas ekspertës së caktuar nga Këshilli, shkalla e zotërimit të gjuhës së huaj angleze nga kandidati Asim Vokshi është vlerësuar me 3 pikë.

35. Këshilli, vlerësoi të dhënat që përmban dosja e kandidimit nga ku rezulton se kandidati ka paraqitur dokument vlerësues të vlefshëm për aftësitë e tij gjuhësore në gjuhën e huaj (*italisht*) si dhe është testuar nga ekspertja e caktuar nga Këshilli për nivelin e njohurive të gjuhës (*anglisht*), për rrjedhojë çmoi ta vlerësojë kandidatin Asim Vokshi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **36 Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

36. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kriter vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

37. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysht sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh, sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

¹ Dëshmitë e gjuhëve të huaja janë depozituar fotokopje.

38. Në rastin e kandidatit Asim Vokshi, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

39. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Asim Vokshi ka dorëzuar punimet profesionale si më poshtë vijon:

Artikuj Shkencorë:

Punime të deklaruara sipas vetë kandidatit (dorëzuar fizikisht pranë KED)

- Revista “Studime Juridike 2”, Tirane, fq. 130, 2005. Publikim me temë: “Juridiksioni i gjykatave shqiptare kundrejt të huajve dhe derogimi nga juridiksioni”. Autor Asim Vokshi.
- Reviste juridike “Jeta juridike I”, Tiranë, fq.5, 2010. Publikim me temë: “Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil”. Bashkëautor Asim Vokshi.
- Botim i artikujve të konferencës “Revolucioni digjital dhe ndikimi i tij në marrëdhëniet civile dhe tregtare”, Tiranë, fq. 21. 2021. Publikim me temë: “Risitë dhe sfidat e procesit gjyqësor civil dhe administrativ në epokën digjitale”. Autor Asim Vokshi.
- Botim “Procedura Civile” pjesa 1 si dhe “Procedura Civile” pjesa 2, botime Albas 2018. Asim Vokshi bashkëautor në librat e procedurës civile.
- Dy shkrime publikuar në Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses First Regional Conference, 2010 Volume III. Shkrimi i parë me temë: “Modern Contracts-Republic of Albania- Franchising”, fq. 193. Shkrimi i dytë me temë: “Securities in relation to factoring contracts succession on credits and the registry of factoring”.
- Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses Second Regional Conference, Skopje 2012 Volume I, fq. 445. Publikim me temë: “Solutions for breaches of sales contracts-loss and interest”. Autor Asim Vokshi.
- Journal of Studies on Economics and Society. Publikim me temë: “ Insolvency procedures in relation to other states (cross-border insolvency according to albanian legislacion), fq. 225. Bashkëautor Asim Vokshi.
- International Scientific conference “The state, society and law: between transition and consolidation ”. Publikim me temë: Administrative Justice in Albania, fq. 45. Autor Asim Vokshi.
- Gazeta e TLAS –Botim I shërbimit ligjor Falas Tiranë (TLAS). Publikim me temë: Stop Korrupsionit, fq. 15. Autor Asim Vokshi.

Po ashtu nga jetëshkrimi i kandidatit deklarohen punimet vijuese:

- Publikim me titull: “Autonomia Vendore dhe Kontrolli nga pushtetit qendror në Republikën e Shqipërisë”, autor, Botimet e Konferencës, Universiteti i Prishtinës, 2011.
- Botimi: “E drejta e detyrimeve I” dhe “E drejta e detyrimeve II”, cikël leksionesh, 2008, bashkëautor.
- Publikim me titull Procedura Civile (Gjykimi në shkallë të parë dhe ekzekutimi i detyrueshëm), autor, cikël leksionesh, 2007.

Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- *Publikim i Gjykatës së Lartë: Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti Kombëtar tek Vlerat Universale*” 10 maj 2023. Publikim me temë: “Dimensione të qasjes në drejtësi në raport me gjykimet në Gjykatën e Lartë-Përvoja shqiptare”, fq. 144. Autor Asim Vokshi. Konferencë ndërkombëtare me rastin e 110 vjetorit të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
- *International Scientific Conference “The state, society and law: between transition and consolidation”*. Publikim me temë: *Administrativ Justice in Albania*, fq. 45. Autor Asim Vokshi.
- *Botim i artikujve të konferencës “Revolucioni digjital dhe ndikimi i tij në marrëdhëniet civile dhe tregtare”*, Tiranë, fq. 21. 2021. Publikim me temë: “Risitë dhe sfidat e procesit gjyqësor civil dhe administrativ në epokën digjitale”. Autor Asim Vokshi.
- *Dy shkrime publikuar në Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses First Regional Conference, 2010 Volume III. Shkrimi i parë me temë: “Modern Contracts-Republic of Albania- Franchising”, fq. 193. Shkrimi i dytë me temë: “Securities in relation to factoring contracts succession on credits and the registry of factoring”*.
- *Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses Second Regional Conference, Skopje 2012 Volume I, fq. 445. Publikim me temë: “Solutions for breaches of sales contracts-loss and interest”*. Autor Asim Vokshi.

5 (pesë) dokumentet e përzgjedhura nga kandidati:

- a) *Vendim njësuës i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 4279 (259) datë 07.07.2023, i Gjykatës së Lartë, i njehsuar, gjyqtar relator Asim Vokshi.*
- b) *Vendim nr. 1699, datë 24.04.2023, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i njehsuar, gjyqtar relator Asim Vokshi.*
- c) *Revista juridike shkencore, Jeta Juridike nr.2, Dhjetor 2005, fq. 79. Publikim me temë: “Nuk ka vepër penale, nuk ka dënim pa ligj”. Autori Asim Vokshi.*
- d) *Publikim i Gjykatës së Lartë: Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti Kombëtar tek Vlerat Universale*” 10 maj 2023. Publikim me temë: “Dimensione të qasjes në drejtësi në raport me gjykimet në Gjykatën e Lartë-Përvoja shqiptare”, fq. 144. Autor Asim Vokshi.
- e) *Publikim në Balkan Social Science Review, vol 21, 2023. Publikim me temë: “A practical and analytic approach to the Albanian Mechanism for Violation of Reasonable Length Requirement in judicial Proceedings”. Bashkëautor Asim Vokshi.*

40. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Këshilli vlerëson se në aspektin sasior kandidati Asim Vokshi ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë mbi atë që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit.

Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin Asim Vokshi për këtë kriter ligjor vlerësimi në total me **42 Pikë**.

41. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati Asim Vokshi, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga organet e emërtesës.

42. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati Asim Vokshi ka depozituar pranë Këshillit dokumentacionin përkatës për vlerësim dhe ka përzgjedhur pesë dokumente.

43. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati Asim Vokshi, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

44. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme që lidhen me: *publikime shkencore në fushën e të drejtave procedurale civile; e drejta e detyrimeve dhe kontratave; dimensionimin e qasjes së drejtësisë procedurale dhe gjykimi pranë Gjykatës së Lartë; po ashtu dallohet se kandidati ka përzgjedhur punime të llojit vendime gjyqësore njehsuese dhe vendime pilot të Gjykatës së Lartë, ku spikat roli i tij në cilësinë e anëtarit relator dhe kryesues të trupit gjykues.*

45. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është “*Originaliteti dhe/ose impakti*”, duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka të dhëna për plagjiaturë të punimeve të sipërcituara. Nisur nga profili profesional si *magjistrat karriere* dhe angazhimi akademik afatgjatë i kandidatit Asim Vokshi, përmbajtja e dokumenteve të përzgjedhura, dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se publikimet dhe artikujt e analizuar dëshmojnë qasje profesionale origjinale veçanërisht mbi trajtimin e instituteve që lidhen me të drejtën procedurale civile.

Në cilësitë e tij si akademik spikat kontributi i kandidatit në formimin e brezave të juristëve dhe magjistratëve të rinj dhe kandidati qartësisht shfaqet si një studiues me mendim të thellë dhe aftësi të qarta për të analizuar, përpunuar dhe paraqitur çështje juridike me rëndësi për jurisprudencën. Zgjedhja e temave tregon ndjeshmëri ndaj problematikave sfiduese të kohës dhe aftësi për të identifikuar fusha ku analiza ligjore ka ndikim praktik e teorik.

Përmes një stili të qartë, preçiz dhe të rrjedhshëm, kandidati arrin të ndërthurë njohuritë doktrinale me raste konkrete, duke ndërtuar një linjë argumentuese të qartë e të besueshme. Çdo punim është i organizuar me kujdes, me një rrjedhë logjike që ndihmon lexuesin të kuptojë si aspektet thelbësore, ashtu edhe nuancat më të ndërlikuara të çështjeve të trajtuara. Analiza ligjore është e mbështetur në legjislacion dhe literaturë bashkëkohore, çka i jep argumenteve peshë akademike dhe përdorim praktik.

Vlen të theksohet aftësia e autorit për ta bërë të kuptueshme edhe tematikën më të ndërlikuar, duke e shndërruar në një material të vlefshëm si për studiuesit, ashtu edhe për profesionistët e fushës. Përmes këtij kombinimi të mendimit kritik, përpunimit të kujdesshëm të informacionit dhe stilit të qartë hartues, autori paraqitet si një kontribues serioz e i rëndësishëm në fushën shkencore dhe juridike. Evidentohet se kandidati ka kontribuar në mënyrë të posaçme me vendime gjyqësore të cilat për nga natyra e tyre, kanë impakt të gjerë brenda sistemit gjyqësor dhe për çdo përdorues të gjykatës.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

46. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e publikimeve dhe artikujve profesionalë, kandidati Asim Vokshi tregon zotërimin e thelluar të aftësive analitike për të analizuar informacionin dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve. Më vecanërisht në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë, përcjell në cilësinë e relatorit ose anëtarit, dallohet cilësia e argumentimit dhe koherenca e arsyetimit ligjor, po ashtu spikat stili i të shkruarit, aftësia për të sintetizuar informacionin dhe analiza ezauruese e instituteve ligjore përkatëse. Vendimet e hartuara dallohen jo vetëm për korrektesën formale dhe qartësinë e strukturës, por edhe për mënyrën origjinale të trajtimit të çështjeve komplekse, duke ofruar interpretime të reja e të qëndrueshme.

47. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidati Asim Vokshi, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë, të paraqitur në dosjen e kandidatit. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të lidhura me fusha të larmishme të së drejtës, kryesisht me aspekte të zhvillimit të legjislacionit procedural. Për arritjen e lëndës së trajtuar dhe qëllimin e trajtimit shkencor, nga përmbajtja e secilit prej punimeve të shqyrtuara, adresohen analiza krahasimore duke përdorur burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore, vendase dhe ndërkombëtare. Vërehet gjithashtu, një kujdes i vecantë lidhur me rregulltësinë e citimeve të burimeve të përdorura dhe qëndrueshmëri në stilin e këtyre citimeve.

48. Për treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, u verifikua nëse në veprimtarinë profesionale të kandidatit janë mbuluar me profesionalizëm tematika e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidati Asim Vokshi, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të parashtrimit të problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim korrekt të terminologjisë juridike dhe të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore.

49. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidati Asim Vokshi, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidatit. Këshilli vëren se këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur dhe profesionale. Qartësia e gjuhës së përdorur dhe strukturimi i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

50. Këshilli, pasi shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati Asim Vokshi, për sa i përket vlerësimit cilësor, vjen në përfundimin se kandidati Asim Vokshi vlerësohet në total me **198 Pikë**.

C. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

51. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

52. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës.

Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

53. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati Asim Vokshi, Këshillit i rezulton se karriera profesionale e këtij kandidati është fokusuar kryesisht në profilin e një magjistrati karrierë akademik duke avancuar brenda sistemit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit dhe duke pasur përvojë profesionale në gjykimin civil, administrativ, penal si dhe fusha të posaçme të gjykimit (si psh në mosmarrëveshje që lidhen me mënyrën e zbatimit të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë), po ashtu kandidati ka një përvojë të qëndrueshme në fushën akademike. Kandidati është i mirënjohur për kontributin e tij profesional në fushën e të drejtës civile, administrative dhe asaj kushtetuese.

54. Këshilli vëren se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidati Asim Vokshi, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar vetjak profesional për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike pranë Universitetit të Tiranës dhe Shkollës së Magjistratues. Nga ana tjetër, edhe rrugetimi i tij personal në fushën akademike dhe studimet e ndjekura, kanë ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e këtij kandidati.

55. Së fundi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar, kandidati Asim Vokshi në cilësinë e autorit ka realizuar punime profesionale dhe artikuj shkencor, të cilat në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë aspekte të ndryshme të së drejtës, veçanërisht e lidhur me njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e lirive themelore e të drejtave të njeriut, por me posacërisht me institutet procedurale civile dhe asaj administrative.

56. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Asim Vokshi **62 Pikë**.

Angazhime profesionale shtesë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

57. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Asim Vokshi, rezulton se ka pasur këto angazhime shtesë profesionale:

57.1 Pjesëmarrje në Konferenca shkencore:

- *Publikim i Gjykatës së Lartë: Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti Kombëtar tek Vlerat Universale* 10 maj 2023. Publikim me temë: “Dimensione të qasjes në drejtësi në raport me gjykimet në Gjykatën e Lartë-Përvoja shqiptare”, fq. 144. Autor Asim Vokshi. Konferencë ndërkombëtare me rastin e 110 vjetorin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
- *International Scientific Conference “The state, society and law: between transition and consolidation”*. Publikim me temë: *Administrative Justice in Albania*, fq. 45. Autor Asim Vokshi.
- *Botim i artikujve të konferencës “Revolucioni digjital dhe ndikimi i tij në marrëdhëniet civile dhe tregtare”*, Tiranë, fq. 21. 2021. Publikim me temë: “Risitë dhe sfidat e procesit gjyqësor civil dhe administrativ në epokën digjitale”. Autor Asim Vokshi.
- *Dy shkrime publikuar në Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses First Regional Conference, 2010 Volume III*. Shkrimi i parë me temë: “Modern Contracts-Republic of Albania- Franchising”, fq. 193. Shkrimi i dytë me temë: “Securities in relation to factoring contracts succession on credits and the registry of factoring”.
- *Civil Law Forum for South East Europe, Collection of studies and analyses Second Regional Conference, Skopje 2012 Volume I*, fq. 445. Publikim me temë: “Solutions for breaches of sales contracts-loss and interest”. Autor Asim Vokshi.

57.2 Angazhime të tjera shtesë:

Me shkresën nr. 240/1 prot., datë 11.06.2025 të Shkollës së Magjistraturës është përcjell informacion në lidhje me angazhimet profesionale të kandidatit Asim Vokshi pranë Shkollës së Magjistraturës, si vijon:

“Z. Asim Vokshi është angazhuar pranë Shkollës së Magjistraturës në Programin e Formimit Fillestar, si pedagog i jashtëm i lëndës “E drejtë e procedurës civile”; është angazhuar në drejtimin e gjyqeve imituese, si dhe ka qenë pjesë e komisioneve të hartimit të tezave, por edhe të korrigjimit të tezave të fazës së dytë të provimit përfundimtar, si dhe pjesë e komisionit të korrigjimit të memove ligjore të kandidatëve të vitit të dytë.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 ka qenë anëtar i Komisionit të Hartimit të tezave të provimit të pranimit, miratuar me urdhrin nr. 50, datë 29.5.2015 dhe 50/1, datë 4.6.2015.

Është miratuar me vendimin nr. 27, datë 24.9.2018, “Për miratimin e listës së pedagogëve në dispozicion në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2018-2019”, në lëndën e procedurës civile. Këtë vit akademik Asim Vokshi nuk është angazhuar në mësimdhënie, por ka qenë një nga udhëheqësit e temave të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë për vitin akademik 2018-2019.

Me vendimin nr. 19, datë 3.10.2019, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm dhe pedagogëve në dispozicion në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2019-2020” është miratuar si pedagog në dispozicion në lëndën e procedurës civile. Gjatë këtij viti akademik nuk është angazhuar në mësimdhënie.

Me vendimin nr. 33, datë 22.9.2020, “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2020-2021” si pedagog i jashtëm në lëndën e procedurës civile dhe ka zhvilluar 78 orë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Me vendimin nr. 28, datë 23.9.2021, "Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2021-2022", është miratuar si pedagog i jashtëm në lëndën e procedurës civile dhe ka zhvilluar 42 orë në lëndën e procedurës civile dhe 12 orë gjyqe imituese.

Me vendimin nr. 29, datë 27.9.2022, "Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2022-2023", është miratuar si pedagog i jashtëm në lëndën e procedurës civile dhe në gjyqet imituese të vitit të dytë. Gjatë këtij viti akademik ka zhvilluar 66 orë në procedurën civile dhe 18 orë gjyqe imituese.

Me vendimin nr. 34, datë 20.9.2023, "Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion dhe specialistëve të Programit të Formimit Fillestar për vitin akademik 2023-2024", është miratuar si pedagog i jashtëm në lëndën e procedurës civile dhe në gjyqet imituese të vitit të dytë. Ka zhvilluar gjithsej 39 orë procedurë civile dhe 16 orë gjyqe imituese.

Zoti Vokshi, përveç mësimdhënies është angazhuar edhe në veprimtari të tjera në Shkollë, si: Anëtar i Komisionit të Vlerësimit profesional të fazës së dytë të provimit të pranimit për vitin akademik 2022-2023 me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 11, datë 25.4.2022, "Për miratimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të fazës së dytë dhe të provimit të pranimit për vitin akademik 2022-2023".

Anëtar i komisionit të Vlerësimit të Memove ligjore, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Shkollës nr. 110, datë 11.6.2024, "Për ngritjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të memove ligjore për kandidatët për magistratë të vitit të dytë, për vitin akademik 2023-2024".

Anëtar i komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional për provimin e pranimit viti akademik 2025-2026, miratuar me vendimin nr. 12, datë 25.4.2025 të Këshillit Drejtues.

Në vlerësimet që kanë dhënë kandidatët për magistratë për vitin akademik 2023-2024, z. Asim Vokshi në rubrikën V "Listoni emrat e pedagogëve të brendshëm që vlerësohen prej jush si më të mirët në drejtimin praktik dhe akademik; për përgatitjen e materialeve të trajnimit me cilësinë dhe sasinë e duhur, të cilët spikasin me modelin e tyre etik dhe komunikues" ka marrë 16 vlerësime, si dhe në rubrikën IX "Konsideratat e shkallëzuara për pedagogët e brendshëm, të jashtëm, pedagogët në dispozicion, as pedagogët, specialistët, që ju kanë dhënë mësim në mënyrë më të detajuar", 36 kandidatë e kanë vlerësuar maksimalisht, nga 81 kandidatë që kanë plotësuar formularët e vlerësimit".

57.3. Po ashtu nga jetëshkrimi i kandidatit Asim Vokshi dhe dokumentacioni i përcjell pranë Këshillit, rezulton edhe përvoja profesionale në angazhim si ekspert ndërkombëtar me eksperiencë (*senior*) pranë Projektit EUKOJUST i Bashkimit Evropian në Kosovë (2022-2024); ekspert i Jashtëm në Komision të Ligjeve pranë Kuvendit të Shqipërisë (shkurt-mars 2017); pedagog i jashtëm, pranë Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës (2006-2015).

58. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të legjislacionit në fusha diverse të së drejtës. Angazhimi si lektor i jashtëm, kontributi në botime profesionale dhe pjesëmarrje në projekte juridike kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në konferenca shkencore shtojnë dukshëm atributet profesionale të kandidatit.

59. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të "*angazhimeve profesionale shtesë*", t'i caktojë kandidatit Asim Vokshi **33 Pikë**.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Meritat Morale

60. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për “integritetin etik e moral”. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter “Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kritere vlerësimi edhe “Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve” dhe “cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi”. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

61. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 10 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

62. Në lidhje me “meritat morale”, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, mbahen parasysh edhe gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidatit, ku përmbahen të dhëna që kanë të bëjnë apo mund të përdoren për efekte të vlerësimit të integritetit etik e moral të kandidatit, angazhime në kauza të shoqërisë civile etj. Gjithashtu, për këtë komponent të vlerësimit mbahen parasysh edhe të dhëna e përfundime që mund të nxirren gjatë intervistës së kandidatit me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

63. Nga kandidati në lidhje me këtë kriter nuk janë dorëzuar dokumente që kanë të bëjnë me vlerësime të marra nga institucionet pranë të cilës ka ushtruar veprimtarinë profesionale.

64. Në rastin e kandidatit Asim Vokshi, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

Integriteti etik e moral

65. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga të dhëna të tjera të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

disponueshme, përfshi ecurinë e karrierës brenda sistemit gjyqësor të kandidatit, Këshillit i rezulton se kandidati Asim Vokshi në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje për t'iu përgjigjur me kujdesin e duhur pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

66. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “integritetit etik e moral” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Asim Vokshi në total **161 Pikë**.

Reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

67. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidati Asim Vokshi në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij nuk heziton të tregojë angazhim në përmbushjen e detyrave të tij. Sipas të dhënave që disponohen Këshillit i rezulton se kandidati Asim Vokshi reflekton përgjegjshmëri në angazhimet e tij profesionale. Vlerësimet në komunitetin juridik dhe mungesa e shënimeve negative publike e vendosin reputacionin në nivel të lartë.

68. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Asim Vokshi në total **83 Pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

69. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, kandidati Asim Vokshi ka kontribut në kauzat e shoqërisë civile përmes impaktit të aktivitetit të tij profesional por nuk evidentohet dokumentacion mbështetës për pjesëmarrje më aktive në këtë kauzë.

70. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile” Këshilli vlerëson kandidati Asim Vokshi në total me **2 Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

71. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kriterë vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

72. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

73. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësia e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

74. Në rastin e kandidatit Asim Vokshi krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të këtij kandidati.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

75. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatit Asim Vokshi lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballët Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësiave dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

76. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidati Asim Vokshi ka njohuritë mbi rëndësinë e misionit, kërkesave etike morale dhe profesionale që dikton pozicioni i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese si edhe të kësaj Gjykate, në respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi të mirëfunksionimit të sistemit demokratik dhe shtetit ligjor. Gjithashtu, ky kandidat parashtroi aftësitë dhe përkushtimin e tij për përmbushjen e misionit të Gjykatës Kushtetuese.

77. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” Këshilli vlerësoi t’i caktojë kandidatit Asim Vokshi në total **24 Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

78. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësëpari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtarie profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

79. Në rastin e kandidatit Asim Vokshi, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli evidenton se kandidati për shkak të ushtrimit të detyrës funksionale si gjyqtar prej shumë viteve në nivele të ndryshme të sistemit gjyqësor dëshmon aftësi të lartë peshuese dhe konsistente në vendimmarrje.

80. Këshilli evidenton në lidhje me kandidatin Asim Vokshi se për shkak të ushtrimit të detyrës funksionale si gjyqtar prej shumë viteve në nivele të ndryshme të sistemit gjyqësor dëshmon aftësi të lartë peshuese dhe konsistente në vendimmarrje. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*”, Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidatit Asim Vokshi në total **34 Pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

81. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

82. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidati Asim Vokshi zotëron aftësi të mira për të komunikuar me kujdesin e duhur, për të dëgjuar me profesionalizëm dhe për tu përgjigjur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët. Prezantimi publik i kandidatit është preciz dhe profesional dhe shfaq potencial për më shumë ekspozim institucional.

83. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*”, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Asim Vokshi **14.5 Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore

84. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjes kësaj Gjykate, duhet të zotërojë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

85. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidati Asim Vokshi zotëron aftësi shumë të mira për të punuar në grup dhe ka të dhëna të qarta në drejtim të organizimit të veprimtarive në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se ky kandidat është përfshirë vijimësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e veprimtarive, publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë. Një vlerë e shtuar në këtë kuadër është patjetër dhe eksperiencia shumëvjeçare në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë hallkave të ndryshme të pushtetit gjyqësor.

86. Gjithashtu, pjesëmarrja në trupa kolegjal dhe bashkëpunimi ndërinstitucional dëshmon kulturën e punës kolektive.

87. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*”, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatit Asim Vokshi **9 Pikë**.

88. Në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidati Asim Vokshi:

- pasqyron profilin gjyqësor të kandidatit me përvojë gjyqësore mbi 19 vjeçare në tri nivele (përfshirë Gjykatën e Lartë); produkt gjyqësor me peshë; formim të avancuar (LL.M., doktoraturë, mesatare shumë të larta), zotërim të gjuhës së huaj me certifikim ndërkombëtar, i konfirmuar edhe me ekspertë,
- dallon për një produkt gjyqësor të nivelit të lartë si relator në vendime njësuere në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë; angazhime akademike dhe në projekte me impakt (p.sh., ekspertizë procedurale, trajnime në Shkollën e Magjistraturës, pjesëmarrje në projekte të BE),
- ka paraqitur një platformë operative dhe të matshme, ku theksohet cilësia e arsyetimit, respekti ndaj jurisprudencës, efikasiteti dhe besueshmëria e vendimeve. Kjo justifikon një vlerësim të lartë në nën-kriterin organizativ.

89. Për sa më sipër, rezulton se kandidati Asim Vokshi ka grumbulluar 805.5 pikë në tërësi, nga vlerësimet e të gjithë anëtarëve të Këshillit për çdo komponent vlerësimi. Sikurse është evidentuar edhe në Kreun II të këtij vendimi, rezultati përfundimtar i kandidatit (i cili është pasqyruar edhe në tabelat përkatëse që gjenden në faqen zyrtare Gjykatës së Lartë, në Rubrikën KED), përftohet nga mesatarja kolegjiale e pikëve të nëntë anëtarëve, rrjedhimisht kandidati Asim Vokshi vlerësohet në total me **89.5 pikë**.

90. Duke peshuar në mënyrë të integruar të tre blloqet dhe provat e dosjes, zbatimi simetrik i metodologjisë e bën totalin **89.5 pikë** proporcional, bindës dhe të qëndrueshëm në leximin

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

kolegjial. Ky vlerësim reflekton profilin gjyqësor të kandidatit, cilësinë e lartë të shkrimit gjyqësor dhe formimin e avancuar, bashkë me meritat morale dhe organizative.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, të pikës 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për Kriteret dhe Procedurën e Vlerësimit, Pikëzimit dhe Renditjes së Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit Asim Vokshi, me **89.5 Pikë** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga, Gjykata e Lartë në datën datë 11.12.2024.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr.115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Asim Vokshi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR

Zv/KRYETARE

KRYETAR

Ilir Toska

Marjana Semini

Sokol Sadushi

ANËTARE

ANËTAR

ANËTARE

Alma Muça

Fuat Vjerdha

Enkela Vlora

ANËTARE

ANËTAR

ANËTARE

Irma Balli

Etien Kapo

Nafije Hasko

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302